



**MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**

Nr. 6614 prot.,
Tiranë, më 08.08.2025



**UNIVERSITETI
BUJQËSOR I TIRANËS**

Nr. 2697 prot.,
Tiranë, më 8.9.2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

DHE

UNIVERSITETIT BUJQËSOR TË TIRANËS

Mbështetur në Ligjin nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, në Ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në Ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitutional për përgatitjen dhe punësimin e të diplomuarve të Universitetit Bujqësor të Tiranës në fushat që lidhen me veprimtarinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, dhe për të përmbushur nevojat e saj për burime njerëzore të kualifikuara, bien dakord si më poshtë,

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është ngritja e një kornize bashkëpunimi ndërmjet Palëve, me synim rritjen e bashkëpunimit nëpërmjet angazhimit të drejtpërdrejtë në çështjet e zhvillimit të bujqësisë, zhvillimit rural, sigurisë ushqimore, veterinarisë, administrimit të ujit dhe të tokës, zbatimin e reformave dhe realizimit me sukses të procesit të integritimit evropian të sektorit.

Neni 2

Fushat e bashkëpunimit

Bashkëpunimi i Palëve do të përfshijë:

1. Lehtësimin e punësimit, të praktikave mësimore dhe të punës për studentët dhe të diplomuarit në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe institucionet e saj të varësisë.
2. Organizimi i aktiviteteve të përbashkëta për organizimin e një *Kuvendi Kombëtar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural* dhe prodhimin e një dokumenti rekomandimesh, si dhe angazhimet konkrete për realizimin e tyre.
3. Përcaktimin e Universitetit Bujqësor të Tiranës si partnerin kryesor të referencës për ofrimin e konsulencave dhe ekspertizës shkencore që i shërbejnë politikëbërjes dhe ndërhyrjeve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat përkatëse.
4. Fushat e konsulencës përfshijnë të gjithë spektrin e ekspertizës së UBT-së (*bujqësi dhe shkencat e tokës, shkencat ushqimore dhe siguria ushqimore, zhvillim rural dhe politika, administrim ferme dhe ekonomi bujqësore, veterinar dhe shëndet publik veterinar, akuakulturë, bioteknologji, burime ujore e të tokës, etj.*). Bashkëpunimi nis me tri konsulencat e mëposhtme:
 - a. Studim mbi vlerësimin e situatës së rezervuarëve ujitës në territorin e Shqipërisë;
 - b. Financimin e studimit mbi hartimin e protokolleve (praktikat e mira) të mbrojtjes së bimëve dhe zbatimin e praktikave të mira bujqësore, me qëllim sigurimin e informacionit të fermerëve për problematikat kryesore të përdorimit të tyre në bujqësi;
 - c. Studim mbi përdorimin e inputeve në bujqësi, duke përfshirë përditësimin e detyrueshëm profesional të ofruesve të shërbimeve në bujqësi (tregtarët e vegjël të inputeve bujqësore).

Neni 3

Drejtimi i bashkëpunimit për procesin e lehtësimin të punësimit të studentëve të diplomuar në Universitetin Bujqësor të Tiranës

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural angazhohet në:

- Krijimin e një procesi të përhershëm bashkërendimi UBT - MBZHR për planifikimin e regjistrimeve, që orientojnë kuotat, profilizimin e studentëve të UBT-së drejt nevojave aktuale dhe të parashikuara të MBZHR-së dhe institucioneve të saj vartëse, i bazuar në sinjalet e tregut të punës, projeksionet e aftësive dhe prioritetet sektoriale.
- Informimin e Universitetit Bujqësor të Tiranës mbi vakancat aktuale dhe të parashikuara në strukturat e Ministrisë që përputhen me fushat e studimit të ofruara nga Universiteti.
- Nga vakancat e hapura të MBZHR-së me prioritet kuotat do të përmbushen me studentë të diplomuar në UBT dhe do të lihen të hapura deri në plotësimin e kësaj kuote nga UBT-ja, sipas ligjit për shërbimin civil ose legjislacionit përkatës të punës (*sipas fushave të diplomimit, veterinar, agronomi, bioteknologji, akuakulturë etj.*).
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për orientimin dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës (*seminare, trajnime, praktika mësimore, profesionale etj.*).

- Mbështetjen për krijimin e bazës së të dhënave të të diplomuarve të Universitetit Bujqësor të Tiranës dhe promovimin e saj pranë strukturave të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Lista fillestare e vendeve vakante në strukturat dhe institucionet e varësisë së Ministrisë, për të cilat Palët bien dakord të bashkëpunojnë për promovimin e tyre pranë të diplomuarve të UBT-së, përshkruhet në aneksin 1, që i bashkëlidhet kësaj Marrëveshjeje dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 4

Detyrimet e MBZHR-së

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural angazhohet:

- Të njoftojë periodikisht Universitetin Bujqësor të Tiranës, për vendet e punës të lira që mund të përputhen me profilin e të diplomuarve.
- Të përfshijë të diplomuarit e Universitetit Bujqësor të Tiranës në proceset përzgjedhëse, në përputhje me ligjin, duke marrë parasysh prioritetin e tyre aty ku është e mundur.
- Të bashkëpunojë me Universitetin Bujqësor të Tiranës për hartimin e programeve praktike dhe trajnimeve për studentët.
- Organizimi i Kuvendit Kombëtar për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, dhe sigurimi i fondeve për mbështetjen e aktiviteteve dhe eventeve që do të zhvillohen dhe dokumentet që do të prodhojë ky bashkëpunimin në vazhdimësi.

Neni 5

Detyrimet e Universitetit Bujqësor të Tiranës

Universiteti Bujqësor i Tiranës angazhohet:

- Të përgatisë dhe t'i vërë në dispozicion Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural listën me të diplomuarit e kualifikuar në fushat që përputhen me nevojat e saj.
- Të informojë studentët dhe të diplomuarit për mundësitë e punësimit dhe procedurat ligjore që duhen ndjekur.
- Të organizojë aktivitete përgatitore dhe orientuese për studentët, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.
- Për organizmin dhe mbështetjen e Kuvendit Kombëtar dhe të aktiviteteve të ndryshme UBT duhet të sugjerojë kandidaturat me cilësinë akademike më të mirë që do të jenë pjesë e grupeve të punës.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet fillimisht me negociata ndërmjet Palëve, dhe nëse nuk arrihet një zgjidhje, do t'i nënshtrohet procedurave të përcaktuara nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

Neni 7
Kohëzgjatja

Kjo Marrëveshje lidhet për një periudhë 3 (tre) vjeçare dhe mund të rinovohet ose ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Marrëveshja e Bashkëpunimit hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të Palëve. Kjo Marrëveshje përgatitet dhe nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe, me të njëjtën vlerë ligjore, të cilat depozitohen në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe në Universitetin Bujqësor të Tiranës.

Për


**Ministrinë e Bujqësisë dhe
Zhvillimit Rural**



The block contains a handwritten signature in blue ink above a circular official stamp. The stamp features the coat of arms of Albania in the center, surrounded by the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL" on the sides, and "TIRANË" at the bottom.

Për

**Universitetin Bujqësor të
Tiranës**



The block contains a handwritten signature in blue ink above a circular official stamp. The stamp features the coat of arms of Albania in the center, surrounded by the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISE" at the top, "UNIVERSITETI BUJQËSOR" on the sides, and "TIRANË" at the bottom.